

Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”

Fakulteti i Filologjisë

Emërtimi i lëndës: **Gjuhësi e përgjithshme**

Departamentet: Letërsi Shqipe, Gjuhë dhe Letërsi Gjermane, Gjuhë dhe Letërsi Frenge

Niveli i kursit: Bachelor, lëndë e detyrueshme (obligueshme)

Viti I, II, III, Semestri: II, III, V

Fondi i orëve: 2 +1 (2 ligjërata, 1 ushtrime)

Kodi:

Vlera në kredite ETCS: 5 kredi Dega e Letërsisë Shqipe, 6 kredi Dega e Gjuhës dhe e Letërsisë Gjermane, 6 kredi Dega e Gjuhës dhe e Letërsisë Frënge

Koha dhe vendi i ligjëratave:

Mësimdhënësi: dr. Sedat Kuçi, profesor i rregullt

Zyra 132 (69), tel. 038/ 222 970; e-mail: sedat.kuqi@ uni-pr.edu

Konsultime: e hënë 12,00-13,00; e martë 12,00-13,00;

Qëllimi i Kursit:

- Kursi Gjuhësi e përgjithshme për studentët e vitit I, II dhe të III të Degëve: Letërsi Shqipe, Gjuhë dhe Letërsi Gjermane, Gjuhë dhe Letërsi Frenge hyn ndër kurset themelore. Ka karakter formues, teorik. Qëllimi kryesor i tij: t’ua bëjë të mundshme studentëve ta njohin objektin e studimit të disiplinës teorike Gjuhësi e përgjithshme (Linguistikë e përgjithshme, General Linguistics), përkatësisht ligjësitë e përgjithshme të funksionimit të gjuhëve njerëzore, mënyrat e studimit të tyre, metodat themelore të studimit në gjuhësi, teoritë më të përhapura në këto studime dhe një ide të përgjithshme për historinë e ideve në këto studime.
- Njohja dhe familjarizimi me konceptet themelore në këto studime është një nga synimet kryesore të kursit.
- Synohet që pas këtij kursi studenti të jetë në gjendje të krijojë një ide më të saktë për vendosjen e dijeve që mund të marrë gjatë studimit të gjuhës shqipe, gjermane, frenge në kuadër të dijes më të përgjithshme mbi gjuhët njerëzore, t’i vendosë ato në kuadër të aparaturës njohëse teorike të përgjithshme dhe t’i bëjë të krahasueshme me dijet për gjuhët e tjera, të arritura mbi bazë të të njëjtave koncepte.

Format dhe metodat e realizimit të programit (Metodologjia e mësimdhënies):

Ligjërata, ushtrime, seminare, konsultime, metoda ndërvepruese (interaktive)

Literatura bazë:

Saussure, F. de: **Kurs i gjuhësisë së përgjithshme**, përk. R. Ismajli, b. II, Dituria, Tiranë, 2002.

Martinet, A.: **Elemente të gjuhësisë së përgjithshme**, përkth. R. Ismajli, bot. III, Dituria, Tiranë, 2002.

Ducrot, O.–Todorov, Tz.: **Fjalor enciklopedik i shkencave të ligjërit**, përkth. R. Ismajli, Rilindja, Prishtinë, 1984.

Lyons, J.: **Hyrje në gjuhësinë teorike**, përkth. E. Lika, Dituria, Tiranë, 2001.

Plani i detajizuar:

Java 1: Objekti i studimit të gjuhësisë. Gjuha – fenomen shoqëror. Funkcionet e gjuhës. Gjuha dhe mendimi. Gjuha dhe komunikimi njerëzor. Gjuhësia – shkencë shoqërore.

Literatura : Ducrot, Oswald – Todorov, Tzvetan, 1984; Ismajli, Rexhep, 1974; Iviq, Milka, 1974; Lyons, John, 2001 dhe literatura plotësuese në klasë.

Java 2: Historia e mendimit mbi gjuhën. Fillimet e gjuhësisë. Greqia dhe Roma e lashtë. India. Mesjeta. Humanizmi dhe Renesanca. Racionalizmi. Shekulli 18. Gjuhësia si shkencë e pavarur – sh. 19. Gjuhësia krahasimtare-historike. Biologjizmi në gjuhësi. Gramatikanët e rinj. Gjeografia gjuhësore.

Literatura : Ducrot, Oswald – Todorov, Tzvetan, 1984; Ismajli, Rexhep, 1974; Iviq, Milka, 1974; Lyons, John, 2001 dhe literatura plotësuese në klasë.

Java 3: F. de Saussure dhe strukturalizmi. Shkolla e Pragës dhe fonologjia. Gjuhësia funksionale e A. Martinet-së. Binarizmi i Jakobsonit. Glosematika daneze. Gjuhësia amerikane – Bloomfield dhe blumfildianistët. Gjuhësia gjenerative-transformacionale. Sociolinguistika. Pragmatika. Gjuhësia tekstore.

Literatura : Ducrot, Oswald – Todorov, Tzvetan, 1984; Ismajli, Rexhep, 1974; Iviq, Milka, 1974; Lyons, John, 2001 dhe literatura plotësuese në klasë.

Java 4: Procesi i komunikimit: Emetimi i mesazhit; Bartja e mesazhit; Receptimi i mesazhit; Termet e komunikimit.

Literatura: Barthes, 1987; Ducrot – Todorov, 1984; Ismajli, 1974; Lyons, 2001; Saussure, 2002.

Java 5: Shenja gjuhësore. Tre tipa shenjash: indicie; ikona; simbole. Shenja gjuhësore dhe shenja jogjuhësore. Struktura e shenjës gjuhësore: shenjuesi dhe i shenjuari; shprehja dhe përmbajtja; arbitrariteti dhe motivimi; konvencionaliteti; asociativiteti. Vlera e shenjës gjuhësore.

Literatura: Barthes, 1987; Ducrot – Todorov, 1984; Ismajli, 1974; Lyons, 2001; Saussure, 2002.

Vlerësimi i parë intermediar (test)

Java 6: Ligjërit, gjuhë dhe të folur; kompetencë dhe performancë. Nyjëtimi i dyfishtë i gjuhës. Raporte sintagmatike dhe raporte paradigmatiske. Kundërvënie (opozicion) dhe kundërshti (kontrast). Sinkroni dhe diakroni. Relevancë dhe redundancë.

Literatura: Barthes, 1987; Ducrot–Todorov, 1984; Ismajli, 1974; Lyons, 2001; Martinet, 2002; Saussure, 2002.

Java 7: Aparati i të folurit, lëvizja e ajrit dhe prodhimi i tingujve. Nyjëtimi i tingujve. Përshkrimi akustik i tingujve.

Literatura: Lyons, 2001; Martinet, 2002; Trubeckoi, 1985.

Java 8: Analiza fonologjike. Tingull (fon) dhe fonemë. Tipare dalluese të fonemave. Variante të fonemave. Neutralizim dhe kryefonemë. Ndërlidhni (korrelacione). Theks dhe tone.

Literatura: Ducrot–Todorov, 1984; Lyons, 2001; Martinet, 2002; Trubeckoi, 1985.

Java 9: Inventari i fonemave të shqipes.

Literatura: Martinet, 2002 dhe literatura që do të jepet në klasë.

Java 10: Fjala, fjala sintaksore, leksema. Morfema dhe tipet e morfemave. Alomorfi.

Literatura: Ducrot–Todorov, 1984; Lyons, 2001; Martinet, 2002.

Java 11: Monema. Llojet e monemave.

Literatura: Martinet, 2002.

Java 12: Fleksioni.

Literatura: Ducrot–Todorov, 1984; Lyons, 2001.

Java 13: Derivacioni: rrënja, tema, shtesat (para-, prapa-, ndër-shtesat).

Literatura: Ducrot–Todorov, 1984; Lyons, 2001; Martinet, 2002.

Java 14: Analiza e përbërësve të pandërmjetmë.

Literatura: Lyons, 2001.

Java 15: Kompozicioni.

Literatura: Ducrot–Todorov, 1984; Lyons, 2001; Martinet, 2002.

Provimi përfundimtar me test (vlerësohet me 50%)

Metodat e vlerësimit (me test):

Vlerësimi i parë intermediar (test): 35%

Angazhimi dhe pjesëmarrja aktive: 10%

Vijimi i rregullt: 5%

Provimi përfundimtar me test 50%

Gjithsej 100%

Literatura shtesë:

- Sapir, E.: **Gjuha**, përkth. V. Nuhiu, Rilindja, Prishtinë, 1986.
Iviq, M.: **Drejtimit në linguistikë**, përkth. S. Drini, Rilindja, Prishtinë, 1974.
Barthes, R.: *Elemente të semiologjisë*, **Aventura semiologjike**, përk. R. Ismajli, Rilindja, Prishtinë, 1987.
Hudson, Grover: **Essential Introductory linguistics**, Blackwell Publishers, Massachusetts dhe London, 2000.
Hudson, R. A.: **Sociolinguistika**, përkth. M. Ymeri, Dituria, Tiranë, 2003.
Ismajli, R.: **Shenjë e ide**, Rilindja, Prishtinë, 1974.
Linke, A.ë Nussbaumer, M.ë Portmann, P. R.: **Studienbuch Linguistik**, Niemeyer, Tuebingen, 1996.
Nuhiu, V.: **Ndërndikimet gjuhësore**, Rilindja, Prishtinë, 1985.
Trubeckoi, N. S.: **Parime të fonologjisë**, përkth. M. Bejta, Rilindja, Prishtinë, 1985.

LLOGARITJA E NGARKESËS SË STUDENTIT

LËNDA: **GJUHËSI E PËRGJITHSHME PËR DEGËT: LETËRSI SHQIPE, GJUHË DHE LETËRSI GJERMANE, GJUHË DHE LETËRSI FRËNGE**
MËSIMDHËNËSI: PROF. DR.SEDAT KUÇI

KONTRIBUTI NË NGARKESËN E STUDENTIT

AKTIVITETI	ORË	DITË/JAVË	GJITHSEJ
LIGJËRATA	2	15	30
USHTRIME TEORIKE	1	15	15
KONTAKTET ME MËSIMDHËNËSIN KONSULTIMET PËR STUDENT NË JAVË 10 MIN.	15	150 MIN. = 2,5 ORË	
KOLOKVIUME, SEMINARE	2	2	4
DETYRA TË SHTËPISË	1	15	15
KOHA E STUDIMIT VETANAK TË STUDENTIT (NË BIBLIOTEKË OSE NË SHTËPI)	3	15	45
PËRGATITJA PËRFUNDIMTARE PËR PROVIM	15	2	30
KOHA E KALUAR NË VLERËSIM (TESTE, KUIZ, PROVIM FINAL)	1,5	3	4,5
PROJEKTET, PREZANTIMET, ETJ.	1,5	1	1,5

NGARKESA TOTALE			146,5 ORË

$$146,5 : 25 = 5,86 \text{ KREDITE-ECTS}$$

